

Në kuadër të "Ditëve të Informimit", Ministria e Arsimit dhe Sportit, Dhoma e Tregëtisë dhe Industrisë Tiranë, bashkëpunuan për të zhvilluar panairin "Work & Study 2025".

Edhe këtë vit, ky panair u ofroi institucioneve të arsimit të lartë mundësinë të promovojnë dhe të njohin nxënësit maturantë me ofertën e tyre, lidhur me programet e studimit për vitin akademik 2025-2026.

Pjesë e këtij panairi ishte edhe Universiteti "Eqrem Çabej", i cili ekspozoi ofertat e veta, për të përshtatur kërkesën e tregut me formimin profesional.

